

i FLETËUDHËZUES I PAKETIMIT:
Informacion për pacientin

PAPAVERINE

Tretësirë për injeksion – 40 mg / 1 ml
(Papaverinë klorhidrat)

**Lexojeni me kujdes këtë fletëudhëzues
përpara se të filloni përdorimin e barit.**

- Ruajeni këtë fletëudhëzues. Mund të keni nevojë ta lexoni përsëri.
- Në qoftë se keni pyetje të mëtejshme, pyesni mjekun ose farmacistin tuaj.
- Ky bar është përshkruar për ju. Mos e jepni tek persona të tjerë. Mund t'i dëmtojë ata edhe pse mund të kenë të njëjtat simptoma si ju.
- Në qoftë se ndonjë prej efekteve anësore keqësohet ose në qoftë se vëreni ndonjë efekt tjetër anësor që nuk përmendet në këtë fletëudhëzues, ju lutemi të njoftoni mjekun ose farmacistin tuaj.

Në këtë fletëudhëzues:

- Çfarë është Papaverine dhe përse përdoret
- Përpara se të merrni Papaverine
- Si ta merrni Papaverine
- Efekte anësore të mundshme
- Si ta ruani Papaverine
- Informacion i mëtejshëm

1. ÇFARË ËSHTË PAPAVERINE DHE PËRSE PËRDORET

Papaverina është një alkaloid që është prezent tek opiumi, pavarësisht se nuk është e lidhur kimikisht apo farmakologjikisht me alkaloidet e tjera të tij.

Papaverina ushtron një efekt lëshues të drejtpërdrejtë të muskulaturës së lëmuar, efekt që i detyrohet pjesërisht aftësisë së saj për ta frenuar fosfodiesterazën.

Ajo shkakton zgjerimin e koronareve, të enëve trunore e pulmonare dhe të arterieve periferike; lëshon muskulaturën e lëmuar të bronkeve, të aparatit tretës, ureterëve dhe të sistemit biliar.

Papaverine indikohet në:

- spazma viscerales (p.sh. uretrale, biliare dhe kolika gastrointestinale);
- spazma vaskulare të shoqëruara me infarkt akut miokardi (bllokimi koronar);
- angina pectoris;
- embolizëm periferik dhe pulmonar;
- sëmundje vaskulare periferike ku ka një element vazospastik;
- disa gjendje angiospastike trunore.

Mjeku tuaj mund ta ketë dhënë Papaverine për një qëllim tjetër. Pyesni mjekun tuaj në qoftë se doni të dini pse ju është dhënë ky bar.

2. PËRPARA SE TË MERRNI PAPAVERINE

Mos përdorni Papaverine në qoftë se keni:

- mbindjeshmëri ndaj barit;
- bllok të plotë atrioventrikular të zemrës.

Në qoftë se mendoni se keni ndonjë nga gjendjet e përmendura më sipër, këshillohuni fillimisht me mjekun tuaj dhe ndiqni këshillat e dhëna.

Tregoni kujdes të veçantë me Papaverine

Papaverina duhet të jepet me kujdes tek pacientët me motilitet të reduktuar gastrointestinal.

Duhet treguar kujdes në prezencë të shqetësimeve të përcimit kardiak ose në sëmundje të paqëndrueshme kardiovaskulare, kryesisht kur papaverina jepet si injeksion. Papaverina duhet përdorur me kujdes në glaukomë.

Siguria dhe efektshmëria e saj tek fëmijët nuk është përcaktuar.

Në qoftë se nga përdorimi i papaverinës tek pacienti shfaqen shenja apo simptoma të mbindjeshmërisë hepatike, marrja e barit duhet ndërprerë.

Marrja e barnave të tjera

- Kur papaverina përdoret bashkë me depresuesit e SNQ – së, mund të shfaqen efekte additive.
 - Papaverina mund të ulë efektin e levodopës.
- Kërkoni këshillën e mjekut ose të farmacistit nëse njëkohësisht me Papaverine merrni edhe barnat e përmendura më sipër.

Marrja e Papaverine me ushqim dhe pije

Nuk aplikohet.

Shtatzënia

Njoftoni mjekun ose farmacistin tuaj në qoftë se jeni shtatzënë ose po planifikoni të ngeleni shtatzënë dhe këshillohuni me të për përdorimin e këtij bari gjatë shtatzënisë.

Ushqimi me gjii

Njoftoni mjekun ose farmacistin tuaj në qoftë se ushqeni foshnjën me qumësht gjiri dhe këshillohuni me të për përdorimin e këtij bari gjatë kësaj periudhe.

Drejtimi i automjetit dhe përdorimi i makinerive

Papaverina mund të shkaktojë marrje mendsh dhe përgjumje, ndaj duhet bërë kujdes me drejtimin e automjetit dhe përdorimin e makinerive gjatë trajtimit me të.

3. SI TA MERRNI PAPAVERINE

Gjithmonë merrni Papaverine sipas këshillës së mjekut. Në qoftë se nuk jeni i sigurt, kontaktoni me mjekun ose farmacistin. Në qoftë se ndjeni që efektet e Papaverine janë shumë të forta ose shumë të dobëta, flisni me mjekun ose farmacistin tuaj.

Doza fillestare, me injektim të ngadalshëm në muskul ose në venë, për të rriturit:
30 mg; dozat që vijojnë: 30 – 120 mg, çdo 3 orë, sipas nevojës.

Në qoftë se keni marrë më shumë Papaverine

Në qoftë se keni marrë më shumë Papaverine se sasia që duhet të merrnit, ose në qoftë se fëmijët e kanë marrë gabimisht këtë bar, ju lutemi të kontaktoni mjekun tuaj, spitalin, ose të telefononi urgjencën për të marrë një mendim për rrezikun dhe këshillë për veprimet që duhet të ndërmerren.

Në qoftë se harroni të merrni Papaverine

Në qoftë se harroni një dozë, merrni dozën në vazhdim kur të jetë koha për marrjen e zakonshme të saj.
Mos merrni një dozë të dyfishtë për të plotësuar dozën e harruar!
Në qoftë se keni pyetje të mëtejshme mbi përdorimin e këtij produkti, pyesni mjekun ose farmacistin tuaj.

4. EFEKTE ANËSORE TË MUNDSHME

Të gjitha barnat mund të shkaktojnë efekte anësore. Ndonjëherë ato janë serioze, shumicën e herëve jo.

Papaverine mund të shkaktojë:

- në sistemin kardiovaskular: shtim të ritmit të zemrës, rritje të lehtë të presionit të gjakut, hipotension ortostatik;
- në SNQ: depresion, marrje mendsh, dhimbje koke, përgjumje, lodhje, letargji;
- në aparatit tretës: konstipacion, të përziera, diarre, tharje goje, anoreksi, shqetësime abdominale;
- efekte dermatologjike: skuqje të fytyrës, djersitje, kruarje;
- efekte hematologjike: eozinofili.

Është konstatuar edhe ikter e hepatit.

Njoftoni mjekun tuaj në qoftë se ndonjë prej efekteve anësore të përmendura më sipër ju shqetëson.

Në qoftë se vëreni efekte anësore që nuk janë të përmendura në këtë fletëudhëzues, ju lutemi të njoftoni mjekun ose farmacistin tuaj.

5. SI TA RUANI PAPAVERINE

Mbajeni larg fëmijëve!

Mos e përdorni Papaverine pas datës së skadencës e cila është e shënuar në paketim.

Mos e ruani në temperaturë mbi 25°C!

Ruajeni në paketimin origjinal për ta mbrojtur nga drita dhe lagështia!

Kujdes! Ampula është vetëm për një përdorim.

6. INFORMACION I MËTEJSHËM

Çfarë përmban Papaverine

Lënda vepruese është papaverinë klorhidrat. Çdo ampulë 1 ml përmban 40 mg papaverinë klorhidrat.

Përbërësit e tjerë janë: EDTA kalciumi dhe natriumi, acid klorhidrik mund të shtohet për rregullim pH, ujë për injeksion.

Përmbajtja e paketimit

Kuti me 10 ampula.

Kuti me 100 ampula (përdorim spitalor).

Shpjegues i ikonave ilustruese për paketim:



Sipas recetës së mjekut.



Përmbajtja.



Kujdes.



Tretësirë për injeksion.

Mbajtësi i autorizimit për tregtim dhe prodhuesi:



PROFARMA Sh.a.
Rruga "Myslym Keta"
Tel.: 00355 4 23 89 602
Tiranë - SHQIPËRI

Ky fletëudhëzues u rishikua për herë të fundit në Janar 2012.

SPECIFICATION



CROPPING AREA 12 x 19 cm

PAY ATTENTION, all the layers are visible.

If you have to print this document please check or uncheck the specific layers.